

Vendim nr. 76 datë 13.04.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 13.04.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (F) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **FEDIR ALPATOV**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 655, datë 24.08.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; nr. 10-2022-1358 (325), datë 20.09.2022 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2022-1477, datë 17.11.2022 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 28, pika 1, 31, shkronja “a”, 42, pika 2, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 20.08.2022, punonjësit e Komisarariatit të Policisë Gramsh kanë bërë shoqërimin e shtetasit M.Z, me shtetësi ruse, i cili ka bërë filmime dhe fotografime të fshehta, nëpërmjet pajisjeve speciale elektronike të fotografimit, në ambientet e rrethimit të brendshëm të objektit ushtarak “Uzina e Mekanike Çekin-Gramsh, si dhe kishte kryer veprime të dhunshme ndaj rojeve të objektit. Po ashtu, në ambientet e Drejtorisë së Policisë Elbasan janë shoqëruar më pas edhe shtetasit Fedir Alpatov (*kërkuesi*) me shtetësi ukrainase dhe S.T. me shtetësi ruse, të cilët më herët kanë qenë të shoqëruar me shtetasin M.Z, por kishin arritur të largohen nga vendi i ngjarjes.

2. Oficeri i Policisë Gjyqësore ka kryer veprimet e para për dokumentimin e ngjarjes, ku ndër të tjera ka pyetur si persona nën hetim edhe tre shtetasit e huaj të shoqëruar në ambientet e policisë, ku për secilin prej tyre, përfshirë edhe kërkuesin, organi procedues ka caktuar avokat mbrojtës kryesisht, si edhe përkthyes të gjuhës angleze dhe asaj ruse. Me urdhër të prokurorit, për procesverbalin e dokumentimit të pyetjes së kërkuesit, sikundër edhe për ato të dokumentimit të pyetjes së dy të dyshuarve të tjerë, është vendosur ruajtja e sekretit hetimor deri në përfundim të hetimeve paraprake, sipas nenit 279, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), me arsyetimin se dekonspirimi i tyre do të dëmtonte rëndë hetimin dhe pengonte vazhdimin normal të tij. Në vijim, në datën 21.08.2022, oficeri i policisë gjyqësore ka bërë arrestimin në flagrancë të kërkuesit, si i dyshuar për veprat penale “Dhënia e informatave sekrete” dhe “Sigurimi i informatave”, të parashikuara nga nenet 213 dhe 214 të Kodit Penal (*KP*). Sipas akteve të dosjes, edhe dy shtetasit e tjerë të dyshuar janë arrestuar në flagrancë nga oficeri i policisë gjyqësore. Po në këtë datë, oficeri i policisë gjyqësore ka referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan materialin kallëzues, mbi të cilin ajo, po në këtë datë, ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “Goditjet për shkak të detyrës”, të parashikuar nga neni 237/5 i KP-së, duke regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale emrat e tre shtetasve të huaj, përfshirë edhe atë të kërkuesit. Më pas, në datën 23.08.2022, në regjistër është shënuar edhe vepra penale “Sigurimi i informatave” e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga nenet 214 dhe 25 të KP-së. Në kuadër të procedimit penal, në datën 23.08.2022, prokurori i çështjes i ka kërkuar gjykatës së shkallës së parë vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “Arrest në burg” për të tre personat nën hetim, përfshirë dhe kërkuesin.

3. Shqyrtimi i kërkesave të prokurorit në gjykatën e shkallës së parë është bërë me dyer të mbyllura në seancën gjyqësore të datës 24.08.2022, në të cilën kërkuesi ka qenë i pranishëm.

Po ashtu, në të kanë qenë të pranishëm, krahas dy personave të tjerë nën hetim, edhe mbrojtësit e caktuar kryesisht për ata, si dhe përkthyesi i gjuhës ruse. Në seancë është paraqitur avokati S.V., i cili ka deklaruar se ishte zgjedhur si mbrojtës i kërkuesit nga familjarët e tij, sipas një dokumenti me shkrim në gjuhë të huaj, të lëshuar nga një person i identifikuar si babai i kërkuesit. Ky dokument është përkthyer nga përkthyesi i pranishëm, i cili ka ndihmuar në komunikimin me kërkuesin, ndërsa ky i fundit ka deklaruar se do të mbrohej me avokatin e zgjedhur nga familja, deklarim mbi të cilin avokati S.V. është legjitimuar nga gjykata si mbrojtës i kërkuesit. Pasi i është mundësuar komunikimi me kërkuesin, në kërkesat paraprahe mbrojtësi ka kërkuar që, bazuar në nenet 128/a dhe 256 të KPP-së, të deklaroheshin të pavlefshme deklaratimet e kërkuesit përpara oficerit të Policisë Gjyqësore, karta e të drejtave të të arrestuarit, procesverbali i kontrollit personal të kërkuesit dhe procesverbalet e sekuestrimit të automjetit e sendeve personale të tij, mbi pretendimin se pyetja e kërkuesit dhe përkthimi i akteve procedurale në fjalë ishin bërë në gjuhën ruse dhe jo në gjuhën e tij amtare, atë ukrainase, në kundërshtim me nenin 28, pika 1, të Kushtetutës dhe nenet 8, pika 2 dhe 98, pika 2, të KPP-së.

4. Gjkata nuk e ka pranuar kërkesën me arsyetimin se çmuarja e pavlefshmërisë së akteve të hetimit paraprahe nuk mund të bëhet në këtë fazë, por nga gjyqtari i seancës paraprahe nëse ajo nuk bëhet nga prokurori. Pas kësaj ka vijuar shqyrtimi gjyqësor, ku personat nën hetim janë ndihmuar nga përkthyesi i pranishëm në gjuhën ruse.

5. Në përfundim të shqyrtimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr. 655, datë 24.08.2022, ka vendosur: *“Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrance të bërë ndaj personave nën hetim ..., Fedir Alpatov dhe ..., si të dyshuar për kryerjen e veprave penale “Sigurimi i informatave”, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 214 e 25 i KP-së dhe “Goditja për shkak të detyrës”, e parashikuar nga neni 237/5 i KP-së. Caktimin si masë sigurimi personal ndaj personave nën hetim ..., Fedir Alpatov dhe ..., atë të “Arrestit në burg”, të parashikuar nga neni 238 i KPP-së”*. Gjykata ka vlerësuar se arrestimi në flagrancë ishte bërë konform kërkesave të nenit 251 të KPP-së dhe se në rastin konkret ekzistonin kushtet dhe kriteret e parashikuara nga nenet 228, 229 dhe 230 të KPP-së, për caktimin ndaj personave nën hetim të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues të “Arrestit në burg”.

6. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka ushtruar ankim edhe kërkuesi, nëpërmjet avokatit mbrojtës të zgjedhur, duke ngritur pretendime për rrëzimin nga gjykata të kërkesës për deklarimin e pavlefshëm të disa akteve procedurale të hetimeve paraprahe. Në

ankim janë ngritur, gjithashtu, pretendime edhe në lidhje me vijimin e shqyrtimit gjyqësor në prani të përkthyesit të gjuhës ruse, gjë për të cilën, sipas ankuesit, gjykata kishte rrëzuar kërkesën për zhvillimin e saj sipas neneve 8 dhe 98 të KPP-së.

7. Shqyrtimi edhe i ankimit të kërkuarit nga gjykata e apelit është bërë në seancën gjyqësore të datës 20.09.2022, për zhvillimin e së cilës ajo ka njoftuar paraprakisht edhe Ambasadën e Ukrainës në Republikën e Shqipërisë, pas një kërkesë të saj për të marrë pjesë në seancë në rolin e vëzhguesit dhe për të siguruar një përkthyes të gjuhës ukrainase për kërkuarin, veprim të cilin gjykata ua ka bërë të ditur palëve gjatë seancës. Në atë seancë kanë qenë të pranishëm kërkuari dhe mbrojtësi i zgjedhur, sikundër edhe dy personat e tjerë nën hetim si dhe mbrojtësit e tyre. Në seancë ka qenë e pranishme edhe një përkthyesë e gjuhës ruse. Në kërkesat paraprake, mbrojtësi i kërkuarit ka kërkuar që seanca të zhvillohej në prani edhe të një përkthyesi të gjuhës ukrainase, si gjuha amtare e kërkuarit. Gjyqtari i çështjes ka bërë të ditur për palët se në listën e përkthyesve zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë nuk kishte përkthyes të gjuhës ukrainase dhe se deri në atë moment nuk kishte njoftim për praninë e ndonjë përkthyesi të siguruar nga Ambasada e Ukrainës në Republikën e Shqipërisë. Gjyqtari i çështjes është përpjekur të sqarojë situatën për gjuhën që kërkuari kuptonte duke pyetur atë, si dhe personat e tjerë nën hetim për gjuhën që ata komunikojnë mes tyre. Kërkuari ka deklaruar se komunikonte në gjuhën angleze, kurse personat e tjerë në hetim kanë deklaruar se me kërkuarin komunikojnë pa problem në gjuhën angleze dhe atë ruse. Më tej, gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës për praninë e një përkthyesi të gjuhës ukrainase. Gjykata ka filluar shqyrtimi gjyqësor dhe kërkuari ka dhënë deklaratime që janë përkthyer nga përkthyesja, e cila ka deklaruar se kërkuari e ka kuptuar atë gjatë përkthimit. Në sallën e gjyqimit kanë qenë të pranishme edhe dy zonja, ku njëra është identifikuar si konsulle. Gjykata ka ftuar për të ushtruar funksionin e përkthyeses së gjuhës ukrainase shtetasen e prezantuar si përkthyesë e punësuar në Ambasadën e Ukrainës në Republikën e Shqipërisë, por një gjë e tillë është refuzuar prej saj. Shqyrtimi i çështjes ka vijuar, në prani të përkthyeses së gjuhës ruse, e cila ka përkthyer pyetjet drejtuar kërkuarit dhe përgjigjet e dhëna nga ai.

8. Në përfundim Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 325, datë 20.09.2022, ka vendosur: “*Miratimin e vendimit nr. 655, datë 24.08.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan*”. Gjykata e apelit ka vlerësuar të drejtë, në përputhje me ligjin dhe provat, përfundimin e gjykatës së shkallës së parë për ligjshmërinë e arrestimit në flagrancë të personave nën hetim, si dhe masën e sigurimit personal të caktuar ndaj tyre.

9. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs edhe mbrojtësi i zgjedhur nga kërkuesi, i cili, ndër të tjera, ka pretenduar, se gjykatat më të ulëta kanë gabuar në zbatimin e ligjit procedural që ka të bëjë me gjuhën e akteve, nenet 8, pika 2 dhe 98, pika 3, të KPP-së, duke mohuar të drejtën e përdorimit të gjuhës amtare, si dhe nenin 28, pika 1, të Kushtetutës, pasi kërkuesi është pyetur në gjuhën ruse, ndërkohë që gjuha amtare e tij është ajo ukrainase, shkelje e rëndë procedurale kjo me pasojë pavlefshmërinë e vendimeve të tyre.

10. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2022-1477, datë 17.11.2022 ka vendosur: *“Mospranimin e rekursit të paraqitur nga personat nën hetim Fedir Alpatov dhe S.T., kundër vendimit nr. 325, datë 20.09.2022 të Gjykatës së Apelit Durrës”*, me arsyetimin se në rekurs nuk ngrihen shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së.

11. Me kërkesën e datës 16.03.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë.

II

Pretendimet e kërkuesit

12. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjatë procesit penal të kundërshtuar nuk është garantuar një proces i rregullt, për shkak se nuk është respektuar e drejta për t’u pyetur dhe për t’u ndihmuar nga një përkthyes në gjuhën amtare, e parashikuar nga neni 28, pika 1, i Kushtetutës dhe neni 6, pika 3, shkronja “a”, i KEDNJ-së, si dhe nenet 8, pika 2 dhe 98, pika 2, të KPP-së, pasi ditën e arrestimit ai është pyetur në gjuhën ruse, në një kohë që gjuha e tij amtare është ajo ukrainase, ndërkohë që edhe në shqyrtimin e çështjes në gjykatën e shkallës së parë dhe atë të apelit, pavarësisht se mbrojtësi ka kërkuar caktimin e një përkthyesi të gjuhës amtare, kjo kërkesë nuk është pranuar, duke vijuar shqyrtimi gjyqësor me përkthyes të gjuhës ruse. Gjykata e Lartë ka lejuar shkelje të rëndë të nenit 31, shkronja “a”, të Kushtetutës, pasi kërkuesi ka 5 muaj në paraburgim dhe ende nuk është marrë në pyetje nga organi i akuzës.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1,

shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

15. Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në Gjykatën dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

16. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me funksionin subsidiar të mbrojtjes kushtetuese, që mund të kërkohe vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor (*shih vendimet nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 29, datë 30.03.2017; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit “Arresti në burg”, duke arsyetuar se karakteri i këtij vendimi, që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, e bën atë një vendim përfundimtar në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 40, datë 18.07.2012; nr. 28, datë 23.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin objekt shqyrtimi, kërkuesi pretendon se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor pasi Gjykata e Lartë ka lejuar shkelje të rëndë të nenit 31, shkronja “a”, të Kushtetutës, sepse ka 5 muaj në paraburgim dhe ende nuk është marrë në pyetje nga organi i akuzës. Kolegji vëren se këtë pretendim kërkuesi nuk e ka ngritur në rekursin e tij drejtuar

Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se për sa i përket këtij pretendimi, kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohej kësaj Gjykate, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 8577/2000.

18. Po kështu, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar edhe vendimet gjyqësore për caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal "Arrest në burg", të caktuar fillimisht me vendimin nr. 655, datë 24.08.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe të lënë në fuqi me vendimin nr. 325, datë 20.09.2022 të gjykatës së apelit, ndërkohë që Kolegji Penal me vendimin nr. 00-2022-1477, datë 17.11.2022 ka vendosur mospranimin e rekursit. Për rrjedhojë, konsiderohet se kërkuesi i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohej Gjykatës.

19. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi më i fundit gjyqësor është ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, i datës 17.11.2022, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 02.03.2023, pra brenda afatit 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

20. Në lidhje me kriterin e legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë zhvilluar një proces të rregullt ligjor në drejtim të mosgarantimit të së drejtës së tij për t'u pyetur dhe ndihmuar nga një përkthyes në gjuhën amtare, e cila parashikohet nga neni 28, pika 1, i Kushtetutës, Për rrjedhojë, duke pasur këto pretendime natyrë kushtetuese, do të analizohen në vijim në lidhje me bazueshmërinë e tyre.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për të pasur ndihmën e një përkthyesi.

21. Kërkuesi ka pretenduar se në kundërshtim me nenin 28, pika 1, të Kushtetutës, që gjen zbatim në nenet 8, pika 2 dhe 98, pika 3 të KPP-së, ai është pyetur në ditën e arrestimit në gjuhën ruse ndërkohë që gjuha e tij amtare është ajo ukrainase. Pavarësisht se mbrojtësi i kërkuesit u ka kërkuar gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit caktimin e një përkthyesi të gjuhës së tij amtare, kjo kërkesë nuk është pranuar duke vijuar shqyrtimi me një përkthyes të gjuhës ruse.

22. Sipas nenit 28, pika 1, të Kushtetutës, kushdo, të cilit i hiqet liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet. Personit të cilit i është hequr liria, duhet të njoftohet se nuk ka asnjë detyrim të bëjë ndonjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin, si dhe t'i jepet mundësia për realizimin e të drejtave të tij. Ndërsa sipas nenit 42 të Kushtetutës liria personale nuk mund të

cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e saj, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

23. Në jurisprudencën kushtetuese, referuar edhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), e drejta e individit palë e një gjykimi për t'u informuar në gjuhën që kupton është vlerësuar në funksion të së drejtës së mbrojtjes (*shih vendimin nr. 35, datë 25.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Përveç sa më lart paragrafi 3, shkronja “e”, i nenit 6 të KEDNJ-së parashikon se çdo person i akuzuar ka të drejtën e ndihmës falas të një përkthyesi. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së kjo e drejtë zbatohet jo vetëm për deklaratat me gojë të bëra në seancën gjyqësore, por edhe për dokumentet dhe procedurat paragjyqësore (*shih Hermi kundër Italisë [GC], nr. 18114/02, 18 tetor 2006*). Për sa i përket fazës paraprake, Gjykata vëren se ndihma e një përkthyesi, si ajo e një avokati, duhet të ofrohet që në fazën e hetimit, përveç rasteve kur tregohet se ka arsye bindëse për të kufizuar këtë të drejtë (*shih Baytar kundër Turqisë, nr. 45440/04, § 50, 14 tetor 2014; Diallo kundër Suedisë, nr. 13205/07, § 25, 5 janar 2010*).

25. Në lidhje me të drejtën e të pandehurit për t'u njohur me akuzën dhe aktet në një gjuhë që ai kupton GJEDNJ-ja ka theksuar se është detyrë e autoriteteve vendase që të verifikojnë nëse i pandehuri kupton gjuhën e gjykatës ose gjuhën e akteve (*shih Brozicek kundër Italisë, nr. 10964/84, § 41, 19 dhjetor 1989; Kamasinski kundër Austrisë, nr. 9783/82, § 79, 19 dhjetor 1989*).

26. Sipas GJEDNJ-së, Konventa u le shteteve anëtare hapësirë të gjerë vlerësimi në lidhje me zgjedhjen e mjeteve për të siguruar që sistemi ligjor i brendshëm të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 6 dhe se nuk i takon asaj gjykate të përcaktojë masat konkrete që duhet të ndërmerren nga autoritetet vendase për të verifikuar njohuritë gjuhësore të një të pandehuri që nuk është mjaftueshëm i aftë të njohë gjuhën në të cilën zhvillohen procedurat. Në varësi të faktorëve të ndryshëm, siç është natyra e veprës penale dhe komunikimet që i drejtohen të pandehurit nga autoritetet vendase, një numër pyetjesh të hapura mund të jenë të mjaftueshme për të përcaktuar nevojat gjuhësore të të pandehurit. GJEDNJ-ja ka vënë theksin në rëndësinë e shënimit në procesverbal të çdo procedure të përdorur dhe vendimi të marrë në lidhje me verifikimin e nevojave për përkthim, çdo njoftimi të së drejtës për një përkthyes dhe çdo ndihmë të dhënë nga përkthyesi, siç është përkthimi me gojë ose përmbledhja me gojë e dokumenteve, në mënyrë që të shmanget çdo dyshim në këtë drejtim që mund të ngrihet më vonë gjatë procedurave (*shih Vizgirda kundër Sllovenisë, nr. 59868/08, §§ 84, 85, 28 gusht 2018*).

27. Duke iu kthyer çështjes konkrete në shqyrtim, Kolegji vëren se Gjykata e Apelit Durrës, pasi ka sqaruar fillimisht disponimin e ndërmjetëm për rrëzimin e kërkesës për caktimin e një përkthyesi zyrtar të gjuhës ukrainase për kërkuesin, ka arsyetuar: *“Gjykata mori masat përmes sekretarisë gjyqësore që të caktonte një person nga lista zyrtare e ardhur nga Ministria e Drejtësisë me këtë cilësi, por nuk rezultoi të kishte. Gjykata e Apelit Durrës, pas një kërkesë të Ambasadës së Ukrainës drejtuar kësaj gjykate për të marrë pjesë në seancë nën rolin e vëzhguesit dhe për të siguruar një përkthyes të gjuhës ukrainase për shtetasin person nën hetim, njoftoi ambasadën përmes një e-mail-i zyrtar për ditën, datën dhe orën e seancës. Rezultoi se prezent në gjykim nga kjo përfaqësi diplomatike të ishin një zonjë e prezantuar si konsulle dhe një zonjë e prezantuar si përkthyesë e gjuhës ukrainase. Përkthyesja e prezantuar si e tillë refuzoi ftesën e gjykatës për të ushtruar këtë funksion në procesin gjyqësor që po zhvillohej. Në këto kushte gjykata vendosi, duke pasur parasysh edhe karakterin urgjent të gjykimit, të vijojë procesin gjyqësor nën asistencën e përkthyeses zyrtare në gjuhën ruse prezent në gjykim.”.*

28. Në vendimin e saj, lidhur me vendimin për vijimin e shqyrtimit gjyqësor në prani të përkthyeses së gjuhës ruse, gjykata e apelit ka vlerësuar: *“[...] për të konkluduar se kjo vendimmarrje e ndërmjetme nuk cenonte të drejtën për proces të rregullt ligjor të personit nën hetim z. Fedir Alpatov, gjykata mbajti parasysh se nga të gjitha të dhënat e fashikullit por edhe perceptimi i drejtpërdrejtë në seancë i sjelljes dhe veprimeve konkludente të personit nën hetim dhe sidomos nga ndëraktiviteti i tij me përkthyesen e gjuhës ruse, tregonin se ai kuptonte krejt normal gjuhën ruse dhe çdo fjali e tij në këtë gjuhë përkthehej krejt normal nga ana e përkthyeses. Gjykata pyeti edhe personat nën hetim se në çfarë gjuhe ato komunikonin me njëri tjetrin gjatë periudhës që njiheshin me njëri tjetrin gjatë periudhës që njiheshin dhe se z. M.Z. dhe znj. S.T. deklaruan dhe në gjuhën ruse dhe në gjuhën angleze. Në këto kushte gjykata vlerësoi se pretendimet e mbrojtësit të zgjedhur dhe sjellja e përfaqësisë diplomatike, e prezumuar si e tillë në seancë, përbënin një përpjekje për krijimin e një shkaku artificial për pamundësimin e zhvillimit të procesit gjyqësor natyralisht dhe sipas afateve prekluzive të gjykimit. Për rrjedhojë, gjykata vendosi të vijojë me gjykimin e kësaj çështje nën asistencën e përkthyeses së gjuhës ruse. Gjykata njohu të drejtën e personit nën hetim që të rekursonte këtë vendim të ndërmjetëm bashkë me vendimin përfundimtar” (shih paragrafët 24-26 të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës).*

29. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, ndër të tjera, ka vlerësuar se, me ndryshimet që ka pësuar KPP-ja me ligjin nr. 35/2017, neni 98, pika 2 i tij, ka parashikuar të

drejtën e personit që nuk flet gjuhën shqipe që të pyetet në gjuhën amtare ose në një gjuhë tjetër që kupton, të zgjedhur prej tij (*shih paragrafin 16 të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*). Gjithashtu, ai ka vlerësuar si të pabazuar pretendimin e kërkuarit se gjykata e apelit ka shkelur ligjin procedural penal dhe të drejtat e tij për t'u pyetur e ndihmuar nga një përkthyes në gjuhën amtare. Ai ka vërejtur se kërkuari nga momenti i arrestimit është përfaqësuar nga një mbrojtës dhe është ndihmuar nga një përkthyes i gjuhës ruse dhe se aktet e provat e marra dhe të verifikuara deri në këtë fazë të procedimit penal, krijojnë bindjen e padyshimtë se kërkuari kupton dhe ka njohuri të gjuhës ruse.

30. Sipas Kolegjit Penal, ligji procedural penal përcakton përkthyesin si një nga pjesëmarrësit e procedimit penal, cilësi që e mbart vetëm një person që ka njohuri të posaçme, i vërtetuar ky fakt nga organi kompetent, Ministria e Drejtësisë, ndaj, në këtë vështrim, personi që mbart cilësinë e përkthyesit zyrtar të miratuar nga Ministria e Drejtësisë, është një person i aftë për të kuptuar e vlerësuar nëse komunikimi në gjuhën ku ai është certifikuar si përkthyes është “i vështirë, i rrjedhshëm, i mirë, shumë i mirë ose mjaft i mirë”, ndërkohë që figura e përkthyesit është e ndryshme nga ajo e një eksperti, por është po aq e rëndësishme për sa kohë ligji procedural penal parashikon përgjegjësinë dhe detyrimin e përkthyesit për të bërë një përkthim të saktë (nenet 123 - 127 të KPP-së). Kolegji Penal ka vlerësuar se nga të dhënat e fashikullit nuk evidentohet asnjë problematikë ose dyshim që kërkuari nuk e kupton gjuhën ruse. Më tej, Kolegji Penal ka interpretuar edhe përmbajtjen e nenit 98, pika 2 të KPP-së, duke analizuar, se shprehja “gjuhë amtare”, sipas Fjalorit të Gjuhës Shqipe do të thotë “gjuha e prindërve/e nënës”. Më tej, ai ka theksuar se neni 28, pika 1, i Kushtetutës përcakton njoftimin e kujtdo të cilit i hiqet liria, *në gjuhën që ai kupton*, për shkaqet e kësaj mase, si dhe për akuzën që i bëhet, ndërkohë që neni 31 i saj parashikon të drejtat kushtetuese të individit në një proces penal, mes të cilave edhe të drejtën për të pasur ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe (shkronja “c”). Sipas Kolegjit Penal, këto dispozita kushtetuese janë në unison me sa parashikon KEDNJ-ja, si dhe me interpretimet e GJEDNJ-së, e cila në jurisprudencën e saj, në lidhje me të drejtën e të pandehurit për t'u njohur me akuzën dhe aktet në një gjuhë që ai kupton, ka theksuar se është detyrë e autoriteteve vendase të verifikojnë nëse i pandehuri kupton gjuhën e gjykatës ose gjuhën e akteve, duke referuar për këtë vendimet e GJEDNJ-së në çështjet *Brozicek kundër Italisë dhe Kamisinski kundër Austrisë*. Mbi këtë bazë, Kolegji Penal, në verifikim të provave të shqyrtuara e të analizuara në këtë proces penal, ka krijuar bindjen se kërkuari nuk ka pasur asnjë vështirësi për të komunikuar në gjuhën ruse (dhe as nuk është pretenduar prej tij se

nuk e kupton këtë gjuhë), ndaj dhe aktet ose veprimet procedurale të hartuara në prani të përkthyesit të kësaj gjuhe, janë të vlefshme dhe të marra në konformitet me rregullat procedurale.

31. Bazuar në sa më sipër, Kolegji vëren se kërkuesi, nga momenti i arrestimit të tij, është përfaqësuar nga një mbrojtës dhe është ndihmuar nga një përkthyes i gjuhës ruse. Po ashtu, nga dokumentet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij shqyrtimi kushtetues, rezulton se në datën 21.08.2022 organi procedues ka vlerësuar të nevojshme të procedohej me asistimin e përkthyesit gjatë kryerjes së veprimeve hetimore me personat nën hetim, duke caktuar për këtë përkthyes të gjuhës angleze dhe asaj ruse. Kërkuesi është pyetur nga oficeri i Policisë Gjyqësore në prani të mbrojtësit dhe asistuar nga përkthyesi i gjuhës ruse, duke mos kundërshtuar praninë e këtij të fundit. Po ashtu, edhe sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 24.08.2022 për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal në ngarkim të kërkuesit, përkthyesi J.GJ., i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, ka përkthyer dokumentet e paraqitura nga avokati dhe ka komunikuar me të arrestuarin (kërkuesin), i cili ishte dakord me avokatin e zgjedhur nga familjarët e tij, duke qenë mjaftueshëm i informuar për akuzën, duke krijuar kështu bindjen që kërkuesi kupton dhe ka njohuri të gjuhës ruse.

32. Kolegji, bazuar në përmbajtjen e nenit 28, pika 1, të Kushtetutës të lidhur me të drejtën për proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, vlerëson se këto dispozita kërkojnë që njoftimin e personit që i është hequr liria të realizohet në gjuhën që ai kupton për shkaqet e masës dhe akuzën që i bëhet atij. Në zbatim të normave kushtetuese dispozitat procedurale penale kanë përcaktuar rregullat e zbatueshme gjatë procedimit penal, përfshirë caktimin e përkthyesit, si një nga pjesëmarrësit e procedimit penal, për qëllimet e mësipërme. Ndërkohë që pretendimet e parashtruara në kërkesë nuk kanë të bëjnë me mosrespektimin e dispozitave procedurale që lidhen me caktimin e përkthyesit, por me njohuritë e veçanta që duhet të ketë ai në drejtim të gjuhës me të cilën ka komunikuar me kërkuesin. Kolegji vëren se qëllimi i normës kushtetuese është që të sigurojë njoftimin e personit të ndaluar në atë masë të mjaftueshme për t'i lejuar atij të kuptojë se përse ndodhet në kushtet e heqjes së lirisë dhe akuzën që i ngarkohet, ndërkohë që pretendimi se ky komunikim duhet të jetë në gjuhën amtare nuk gjen bazë kushtetuese pasi kjo e fundit, sikundër u theksua më lart parashikon standardin kushtetues “në gjuhën që kupton” i zbërthyer përmes jurisprudencës së gjykatës kushtetuese dhe asaj të GJEDNJ-së, jo domosdoshmërisht si gjuha amtare.

33. Bazuar në sa më sipër, Kolegji vlerëson se kërkuesit i janë garantuar të gjitha elementet që kërkon e drejta për proces të rregullt, duke iu siguruar mbrojtja me avokat si edhe

asistimi nga një përkthyes, i cili, siç kanë vlerësuar dhe arsyetuar në mënyrë të plotë dhe të qartë gjykatat, ka siguruar njoftimin dhe komunikimin e tij gjatë kësaj procedure në gjuhën që ai kupton. Për rrjedhojë, pretendimi për cenimin e nenit 28, pika 1, të Kushtetutës në drejtim të garantimit të së drejtës për proces të rregullt është haptazi i pabazuar.

34. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.